

## **Fjalim i deputetit Gazment Bardhi**

13.07.2023

– Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, unë kam bërë 3 pyetje dhe do të doja të merrja përgjigje.

Zonja Inspektore, besoj se ju e dini që unë i jam drejtuar zyrtarisht institucionit tuaj, sepse opozita ka paraqitur një mocion në Kuvend ndaj deputetes Olta Xhaçka (meqenëse ra fjala, zonja Kryetare, besoj se ka mbi 10 ditë që në tryezën tuaj është paraqitur raporti i Këshillit të Legjislacionit dhe duhet të merrni masa për ta çuar çështjen përpara në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren, sepse po bëheni pengesë për zbatimin e një vendimi të Gjykatës

Kushtetuese, kjo është thjesht për kujtesë, meqenëse jemi tek tema), nga ku rezulton se ministrja, njëkohësisht deputetja Olta Xhaçka, së bashku me bashkëshortin e saj janë bërë, investitorë strategjikë në përputhje me një ligj që, në fakt, e kanë votuar të dy në cilësinë e tyre si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.

Sipas këtij statusi, bashkëshorti i ministres dhe deputetes Olta Xhaçka e për rrjedhojë, sipas Kodit të Familjes, edhe vetë ministrja, kanë përfituar në masën 50% të drejtën për të përdorur pasuri publike të shtetit shqiptar, sikundër kanë përfituar lehtësira të tjera, përfshirë reduktimin e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Verifikimi i gjendjes së konfliktit të interesit e mbi të gjitha i ligjshmërisë së pasurisë është nga përgjegjësitë ligjore që ka institucioni juaj. Pavarësisht mocionit, debatit në Kuvend e me radhë, rezulton që ju nuk keni nisur asnjë procedurë verifikimi deri në momentin kur unë i jam drejtuar zyrtarisht institucionit tuaj, sipas përgjigjes së parë të ardhur nga ju. Më pas keni bërë një verifikim, siç më keni informuar, ku, në fakt, nuk keni nxjerrë dot asnjë konkluzion.

Pyetja që kam unë, sipas verifikimit që ju keni kryer, është: cili është burimi i 5 milionë eurove të investimit të familjes së ministres Xhaçka? Sepse, siç e dini, projekti për të cilin është dhënë statusi i investitorit strategjik ka një vlerë prej 5 milionë eurosh. Nga konsultimi që ne kemi bërë lidhur me deklaratat e pasurisë së familjes së ministres, nuk rezulton që ata të kenë burim të ligjshëm në vlerën 5 milionë euro. A keni ju ndonjë informacion se cili është burimi i këtyre të ardhurave dhe a është i ligjshëm ky burim? Shtuar kësaj si nënpyetje: a mundet një deputet i Kuvendit të Shqipërisë të përfitojë të drejtën për të përdorur brigjet e detit, pra një pasuri publike? A mundet që një deputet të votojë një ligj, nga i cili më vonë do të përfitojë vetë?

Pyetja e dytë ka të bëjë me një tjetër rast, që tregon mosveprim nga ana e institucionit tuaj. Besoj se jeni njohur gjatë këtyre ditëve me një pasuri përrallore të padeklaruar të ish - zëvendëskryeministrit, zotit Arben Ahmetaj, që sipas prokurorisë ka fshehur pronësinë mbi dy vila

në bregdet, ka një shumë të konsiderueshme parash të padeklaruara, si dhe ka kryer transaksione të paligjshme për të fshehur paratë e korrupsionit.

Në dijeninë tuaj, a ka qenë zoti Ahmetaj, gjatë këtyre viteve që ka kryer funksionin e ministrit, zëvendëskryeministrit dhe deputetit, subjekt i një hetimi të thelluar nga ILDKPKI-ja? Si ka mundësi që institucioni juaj ka pasur një mungesë veprimi apo nuk ka qenë në gjendje të identifikojë këtë pasuri të paligjshme të këtij zyrtari?

Së treti, gjatë gjithë kësaj kohe që ju jeni në krye të këtij institucioni, rezulton që nuk keni marrë asnjë masë apo sanksion ndaj ndonjë deputeti apo ministri për deklarim të rremë, fshehje të të ardhurave apo fshehje të pasurisë. A besoni vërtet se deputetët apo ministrat, gjatë gjithë kësaj periudhe që ju drejtoni këtë institucion, e kanë qasur të ligjshme pasurinën e tyre?

Perceptimi që ka opinionin publik është se deputetët apo ministrat, në abuzim me detyrën e tyre, përfitojnë para në mënyrë të parregullt. A është ky një perceptim i gabuar i opinionit publik, apo është mosveprim i institucionit tuaj për të verifikuar ligjshmërinë e pasurisë në mënyrë korrekte të secilit prej tyre?

Faleminderit!